

At Frano Gjini (1886 - 1948) në dosjet e Sigurimit të Shtetit

11 mars 1948, në sheshin e varrezave të Rrmajit, në Shkodër, u ekzekutuan me vdekje Imzot Frano Gjini, Imzot Nikollë Deda, At' Çiprijan Nika, At' Mati Prenushi

SEKSIONI

Klerikë

PERIUDHA

1975 - 1975


Procesi gjyqësor i vitit 1948 ndaj MonsinJOR Frano Gjinit dhe klerikëve françeskanë mbetet një nga proceset më të ashpra të diktaturës komuniste në Shqipëri. Në përfundim të gjyqit, u dhanë këto dënime : MonsinJOR Frano Gjini, Dom Nikoll Deda dhe Padër Mati Prendushi u dënuan me vdekje; Dom Tom Laca me burgim të përjetshëm; Padër Gjon Karma dhe Dom Ndoc Sahatçija me nga 15 vjet burg dhe punë të detyruar; Padër Mhill Miraj me 7 vjet; Zef Haxhi dhe Dom Nikoll Shelqeti me nga 5 vjet; ndërsa më i riu në atë kohë, At Zef Pllumi, u dënua me 3 vjet burg dhe punë të detyruar, duke shënuar fillimin e vuajtjeve të tij të gjata. Ky proces përfaqëson një nga goditjet më të forta ndaj klerit shqiptar, duke dëshmuar qartë karakterin represiv dhe politik të drejtësisë së asaj kohe.

Frano Gjini dhe procesi i vitit 1948 në Shkodër: Gjyqi politik kundër klerit katolik dhe dëshmitë nga dosjet e Sigurimit

11 mars 1948, dita kur në sheshin e varrezave të Rrmajit, në Shkodër, u ekzekutuan me vdekje Imzot Frano Gjini, Imzot Nikollë Deda, At Çiprijan Nika, At Mati Prenushi. Dokumentet e proceseve hetimore-gjyqësore shkruajnë se ata u dënuan për “deliktin e dobësimit të mbrojtjes” si dhe akuzën politike se do të organizonin kryengritjen me armë dhe fshehjen e tyre në kishë e në Kuvendin Françeskan të Shkodrës, një akt i inskenuar nga Sigurimi i Shtetit. Procesi gjyqësor i vitit 1948 ndaj Monsinjorit Frano Gjini konsiderohet një nga gjyqet më të bujshme politike të viteve të para të diktaturës komuniste në Shqipëri. Në këtë proces u dënuan me vdekje ai dhe tre klerikë të tjerë, ndërsa gjashtë të pandehur morën dënime me burgim të gjatë dhe punë të detyruar. Sipas burimeve arkivore, procesi u zhvillua nga Gjykata Ushtarake në Shkodër, me akuza për veprimtari armiqësore, lidhje me misione të huaja dhe përpjekje për organizim politik përmes një partie demokristiane. Ndër të dënuarit ishte edhe Zef Pllumi, i cili mori në këtë proces dënimin e tij të parë me 3 vjet heqje lirie dhe punë të detyruar. Vendimi i janarit 1948 parashikonte: Dënim me vdekje për Frano Gjini, Nikollë Deda dhe Mati Prendushi; Burgim të përjetshëm për Tom Laca; Dënime të rënda me burg për Gjon Karma, Ndoc Sahatçija, Mëhill Miraj, Zef Haxhia, Nikollë Shelqeti dhe Zef Pllumi. Në kujtesën publike, ky proces shihet si pjesë e goditjes sistematike ndaj klerit katolik dhe institucioneve fetare, përmes akuzave politike dhe proceseve të montuara. Çfarë përmban dosja në Arkivin e Sigurimit : Fondi 1, Dosja 1302.1a, viti 1975 Dosja hetimore-gjyqësore nr. 1302.1/a e vitit 1975 i përket Ndoc Sahatçisë, një prej të dënuarve në procesin e vitit 1948 kundër klerikëve katolikë në Shkodër. I dënuar fillimisht bashkë me ta , ai përballet sërish me ndjekje penale dekada më vonë, një dëshmi se persekutimi nuk përfundoi me dënimet e para. Në përmbajtjen e dosjes gjenden procesverbale hetimore, akt-akuza, deponime të të pandehurve, ballafaqime me dëshmitarë, pretendca e prokurorit dhe vendime gjyqësore, si dhe dokumente mbi ekzekutimin e disa prej të dënuarve dhe kërkesa të mëvonshme për amnisti. Çështja përfshin figura të njohura të klerit katolik shqiptar, ndër ta Frano Gjini, Mati Prendushi, Nikollë Deda, Tom Laca, Ndoc Sahatçija dhe Zef Pllumi. Dokumentet pasqyrojnë akuzat për organizim komitetesh ilegale, lidhje me misione të huaja dhe përpjekje për krijimin e një partie demokristiane, si dhe qëndrimet mbrojtëse të të pandehurve, të cilët theksojnë karakterin fetar të veprimtarisë së tyre dhe mohojnë çdo aktivitet politik armiqësor. Dosja mbyllet me vendime përfundimtare të organeve gjyqësore ushtarake dhe dokumente mbi ekzekutimin e dënimeve.

Frano Gjini në qendër të procesit të 1948-ës: Ekzekutimi i klerikëve në Shkodër dhe dosjet që zbulojnë persekutimin

MEDIA FAQE #1



Frano Gjini në qendër të procesit të 1948-ës: Ekzekutimi i klerikëve në Shkodër dhe dosjet që zbulojnë persekutimin

INFORMACION

Frano Gjini në qendër të procesit të 1948-ës: Ekzekutimi i klerikëve në Shkodër dhe dosjet që zbulojnë persekutimin


FONDI	1
DOSJA	1302/1.a
TIPOLOGJIA E DOSJES	Hetimore Gjqesore
FAQE	380
KRYETAR I TRUPIT GJYKUES, (GJYKATA E LARTË USHTARAKE)	Misto Bllaci

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

Pretenca e 8 janarit 1948 në Shkodër: Frano Gjini dhe klerikët përballë akuzave politike dhe dënimeve ekstreme

MEDIA FAQE #1



Pretenca e 8 janarit 1948 në Shkodër: Frano Gjini dhe klerikët përballë akuzave politike dhe dënimeve ekstreme

INFORMACION

Pretenca e 8 janarit 1948 në Shkodër: Frano Gjini dhe klerikët përballë akuzave politike dhe dënimeve ekstreme


FONDI	1
DOSJA	1302/1.a
TIPOLOGJIA E DOSJES	Hetimore Gjyqesore
KRYETAR I TRUPIT GJYKUES, (GJYKATA E LARTË USHTARAKE)	Namik Qemali
NR. I FLETEVE	380

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

Dëshmitë e të pandehurve në procesin e Shkodrës (1948): deklarata mbrojtëse dhe mohime për veprimtari armiqësore ndaj shtetit

MEDIA FAQE #1



Dëshmitë e të pandehurve në procesin e Shkodrës (1948): deklarata mbrojtëse dhe mohime për veprimtari armiqësore ndaj shtetit

INFORMACION

Dëshmitë e të pandehurve në procesin e Shkodrës (1948): deklarata mbrojtëse dhe mohime për veprimtari armiqësore ndaj shtetit

FONDI	1
DOSJA	1302/1.a
TIPOLOGJIA E DOSJES	Hetimore Gjyqesore
FAQE	380

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.